



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR MINISTRINË PËR KOMUNITETE
DHE KTHIM**

PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2018

Prishtinë, maj 2019

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Qerkin Morina, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Mehmet Muçaj (udhëheqës i ekipit), Natyra Kasumaj dhe Muharrem Qyqalla (anëtar ekip), nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Florim Beqiri.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	11
4 Qeverisja e mirë.....	19
5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	21
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	27
Shtojca II: Letërkonfirmimi.....	30

Përmbledhje e përgjithshme

Ky raport përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Ministrisë për Komunitete dhe Kthim (MKK) për vitin 2018, i cili përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) për vitin 2018 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 24.12.2018.

Auditimi është fokusuar në:



Niveli i angazhimit për të kryer auditimin është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i ministrisë.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i kualifikuar me theksim të çështjes

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2018 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale përveç çështjes në vijim.

Ministria kishte paguar paga për 21 të punësuar në vlerë prej 100,430€, për pa u paraqitur punonjësit në punë.


Theksim i Çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se vlera e pasurive kapitale, e shpalosur në PFV ishte e mbivlerësuar për 1,044,854€. Ministria nuk kishte bërë bartjen e pasurive kapitale te komunat, për projektet të cilat i kishte financuar, por ato mbahen ende si pasuri në evidencat e ministrisë.

Më gjerësisht shih pjesën 2.1 të këtij raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve, sipas SNISA-ve.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore të raportit janë:



Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2018

Ministri është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresoj të gjitha rekomandimet e dhëna.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson bashkëpunimin e menaxhmentit dhe personelit të Ministrisë gjatë procesit të auditimit.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e Pasqyrave Financiare Vjetore dhe të dhënave tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse Pasqyrat Financiare Vjetore japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase.
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Ne kemi analizuar veprimtarinë e Ministrisë, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP).

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përmbledhje të detajuar të gjetjeve tona të auditimit dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Përgjigjet e menaxhmentit në rezultatet e auditimit mund të gjenden në Shtojcën II.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm

Auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese dhe cilësinë e saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV, përfshirë deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar dhe se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinion i kualifikuar me theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV-të e Ministrisë për Komunitete dhe Kthim për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, shpalosjet dhe raportet tjera përcjellëse.

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të çështjes së përshkruar në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore.

Baza për opinion të kualifikuar

Duke u bazuar në marrëveshjen e Brukselit, përkatësisht në Ligjin nr.04/L-199 për ratifikimin e marrëveshjes së parë ndërkombëtare të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, Qeveria e Kosovës me vendim nr. 06/39 të datës 22.07.2015, ka aprovuar konkluzionet e dakorduara për Shpërbërjen e të ashtuquajturës "Mbrotja Civile" e cila ka funksionuar në komunat veriore të Kosovës, si dhe mbështet zotimet e përcaktuara me këto konkluzione. Përmes këtij vendimi, obligohen ministritë dhe agjencitë përkatëse që të bëjnë zbatimin e konkluzioneve sipas përgjegjësisë ligjore.

Në MKK pas një procesi të rekrutimit me akt emërimi ishin integruar 21 nëpunës të komunitetit serb ish pjesëtarë të "Mbrotjes Civile". Këta punonjës ishin planifikuar të sistemohen nëpër komunat në pjesën veriore të Kosovës.

Zyrtarët e lartcekur në vitin 2018, nuk ishin paraqitur në vendin e punës, përderisa ministria i kishte bërë pagesën e pagave të tyre. Vlera financiare për shpenzimet e pagave për vitin 2018, për 21 zyrtarë ishte 100,430€.

Shkaku i mos paraqitjes në punë të këtyre zyrtarëve ishte mos krijimi i kushteve të duhura për punë, kontrolli i dobët dhe mos monitorimi i tyre nga menaxhmenti i ministrisë.

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion të kualifikuar.

Theksimi i çështjes

Neni 19.3.1- Pasuritë kapitale të regjistruara si investime në vijim, ishin mbivlerësuar për vlerën 1,044,854€. Këto pasuri kishin të bëjnë me projekte të komunave, të cilat ishin financuar nga ministria, por që nuk ishin bartur si pasuri në regjistrat e komunave përfituese, edhe pse për të njëjtat ishte bërë pranimi teknik.

Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë për Komunitete dhe Kthim është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar, dhe për kontrollet e brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP) (me plotësime dhe ndryshime).

Ministri është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave të SNISA-ve, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Organizatat Buxhetore (OB) kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Me këtë rast, ne kemi shqyrtuar çështjet si më poshtë:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.01/2013/MF-shpenzimi i parave publike, si dhe Rregulloren MF nr.02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore ;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve; dhe
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK).

Përveç gabimeve të cilat kanë ndikuar në kualifikim të opinionit dhe theksimit të çështjes, PFV përmbajnë edhe gabimin si në vijim:

Në nenin 19.3.2 të PFV Pasuritë jo-kapitale (me vlerë nën 1,000€) - ishin nënvlerësuar për 134,936€. Kjo kishte ndodhur për shkak se në PFV ishin prezantuar vetëm blerjet e vitit 2018 prej 12,926€, dhe jo pasuria totale prej 147,862€.

DEKLARATA E BËRË NGA ZYRTARI KRYESOR ADMINISTRATIV DHE ZYRTARI KRYESOR FINANCIAR

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në Ministrinë e Financave, mund të konsiderohet e pasaktë.

Lidhur me kërkesat tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi çështje për të ngritur.

2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Rekomandimi A1 Ministri duhet të ndërmerr të gjitha veprimet për të siguruar vijueshmërinë e rregullt në punë të këtyre punonjësve duke bërë monitorimin e vazhdueshëm ashtu siç parashihet me aktet ligjore.

Ministri, gjithashtu, duhet të ndërmerr të gjitha veprimet e duhura për të siguruar bartjen e pronësisë së pasurisë kapitale tek komunat për projektet e përfunduara, si dhe të siguroj prezantimin e plotë të pasurive jo kapitale në PFV.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, prokurimin, burimet njerëzore, pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet në përgjithësi janë të vendosura, por efektiviteti i tyre nuk është në nivelin e duhur. Kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve e sidomos mbikëqyrja e projekteve kapitale kërkojnë përmirësim të mëtejshëm për të parandaluar pa rregullsinë. Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime janë planifikimi i buxhetit, menaxhimi i personelit dhe menaxhimi i subvencioneve.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
Burimet e Fondeve:	8,387,806	8,470,219	8,223,450	4,566,688	7,678,676
Granti i Qeverisë -Buxheti	8,387,806	8,470,219	8,223,450	4,566,688	7,678,676

Në vitin 2018, OB ka shpenzuar 97% të buxhetit final ose 8,223,450€. Pra, realizimi i buxhetit është në nivel të kënaqshëm dhe më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	8,387,806	8,470,219	8,223,450	4,566,688	7,678,676
Pagat dhe Mëditjet	796,000	878,956	878,955	772,801	752,433
Mallrat dhe Shërbimet	375,652	382,652	378,695	344,740	339,439
Shërbimet komunale	16,154	8,611	8,378	9,745	17,987
Subvencionet dhe Transferet	300,000	300,000	299,925	290,000	299,993
Investimet Kapitale	6,900,000	6,900,000	6,657,497	3,149,402	6,268,824

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore përfshirë arsyet dhe ndikim që kanë pasur:

- Buxheti final krahasuar me buxhetin fillestar për paga dhe mëditje ishte rritur për 82,956€. Kjo rritje e buxhetit është rezultat i rritjes së numrit të stafit të zëvendësministrave në MKK dhe rritjes së pagave për kabinetin e ministrit, sipas vendimit të Qeverisë nr. 04/20.
- Rritja e buxhetit për mallra dhe shërbime është bërë me vendim të Qeverisë nr.12/81 të datës 24.12.2018 ku 7,000€ nga shërbimet komunale ishin bartur në kategorinë mallra dhe shërbime.

Çështja B1¹ – Planifikimi i projekteve kapitale

Gjetja

Udhëzuesi për procesin dhe planifikimin e buxhetit kërkon “që të gjitha organizatat buxhetore të bëjnë analizë të hollësishme të projekteve kapitale që propozohen”.

MKK nuk kishte bërë planifikim të mirë të projekteve kapitale. Në tabelën 3.2 të Ligjit të buxhetit të projekteve kapitale për nivelin qendror ishin planifikuar tri projekte. Këto projekte nuk ishin specifikuar dhe detajuar, por kishin vetëm një përshkrim të përgjithshëm dhe vlerën financiare. Projektet e planifikuara ishin: Projekti Rikthimi, Ri integrimi i Komuniteteve (RRK-IV-), faza 4 në vlerë 1,000,000€, Projekti për Kthim (Ndërtimi i shtëpive për të kthyer) në vlerë 2,400,000€ dhe Projekti për Komunitete në vlerë 3,500,000€. Projektet nuk përshkruajnë aktivitetet e sakta, shumat e ndara komunave, numrin e personave përfitues, dhe hollësitë tjera.

Shpjegimet e menaxhmentit janë se është e vështirë të definojnë hollësitë dhe kërkesat lidhur me këto projekte, për shkak se me rastin e planifikimeve buxhetore, shumë nga informatat nuk janë të njohura. Por, konkluzioni jonë është se si shkak i kësaj është neglizhenca e menaxhmentit për të bërë një analizë të hollësishme para se këto projekte të propozohen.

Rreziku

Planifikimi jo i mirë i projekteve kapitale, pamundëson realizimin e tyre në të gjitha komponentat. Rrjedhimisht, kjo rritë rrezikun që ministria të mos shpenzoj fondet në mënyrë efikase dhe objektivat e ministrisë të mos arrihen.

Rekomandimi B1

Ministri duhet të siguroj se gjatë procesit të planifikimit të projekteve kapitale, paraprakisht bëhet një vlerësim i hollësishëm duke planifikuar dhe specifikuar saktë të gjitha komponentat e projektit me të gjitha detajet e duhura, dhe më pas të përfshihen në planin buxhetor.

¹ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C - nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.

3.1.1 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për pagat dhe mëditje ishte 878,956€, shumë e cila ishte shpenzuar në tërësi. Pagat paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave që menaxhohet nga MAP dhe MF.

Çështja A2 Vijueshmëria në punë e punonjësve të MKK

Gjetja Rregullorja Nr. 05/2010 e Orarit të Punës në shërbimin civil, neni 7 pika 1 përcakton se "gjatë orarit të punës të gjithë nëpunësit civil janë të obliguar të jenë në vendin e punës. Çdo nëpunës civil shënohet në librin e vijueshmërisë në punë ose në regjistrin elektronik" dhe pika 2 thekson se "mospërfillja e orarit të punës paraqet shkelje disiplinore.

MKK kishte në funksion Sistemin e Menaxhimit të Vijueshmërisë së Punës (SMVP). Pas rishikimeve tona, ne kemi vërejtur se gjatë vitit 2018 një (1) zyrtar² nuk kishte respektuar orarin e punës sepse për tre muaj brenda vitit kishte munguar pa arsye. Pagesa për periudhën tremujore ishte 1,759€ (3*586.36=1,759€). Vlen të theksohet se drejtori i departamentit edhe pse kishte shqiptuar vërejtje me shkrim ndaj punëtorit për mosrespektim të orarit, nuk kishte ndërmarr ndonjë masë disiplinore.

Kjo kishte ndodhur pasi që menaxhmenti i ministrisë nuk e kishte trajtuar me seriozitet mungesën në punë të punëtorit duke e mbajtur përgjegjës atë në respektimin e orarit të punës sipas kërkesave ligjore.

Rreziku Mos vijueshmëria me rregull në punë rritë rrezikon që shpenzimet për paga të cilësohen si të pa justifikuar dhe të paguara pa asnjë bazë ligjore.

Rekomandimi A2 Ministri duhet të rritë mbikëqyrjen dhe të forcoj disiplinën e vajtje-ardhjes në punë. Lidhur me pagesën më lartë, ne rekomandojmë që menaxhmenti ta shqyrtoj edhe një herë rregullsinë e kësaj pagese, dhe nëse nuk gjinden arsye të vlefshme për pagesë, paratë e paguara t'i kthehen buxhetit të ministrisë.

3.1.2 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime si dhe shërbimet komunale në vitin 2018 ishte 391,263€. Prej tyre ishin shpenzuar 387,073€. Ato kanë të bëjnë me shpenzimet për furnizim me material zyrtar, derivate të naftës, shërbime kontraktuese, shërbime komunale, udhëtime zyrtare, shërbime të mirëmbajtje etj.

² Udhëheqës i divizionit për politika dhe planifikim

Çështja B2 - Mangësi në procesin e pagesave

- Gjetja** Rregulla nr. 01/2013 për Shpenzimin e Parasë Publike, parasheh se fillimisht duhet të procedohet zotimi i mjeteve, lëshohet urdhër blerja, dhe pas pranimit të blerjeve bëhet raporti i pranimit, si dhe pranohet fatura.
- Në pesë (5) pagesa për mallra dhe shërbime kemi identifikuar se zotimi dhe urdhër blerja ishte bërë pas pranimit të faturës.
- Kjo ka ndodhur për shkak të dobësive në kontrollet e brendshme, për ta parandaluar këtë praktikë që po përsëritet vit pas viti.
- Rreziku** Mos aplikimi i procedurave të duhura të kontrollit gjatë procesit të pagesave, mund të ndikojë që ministria mos t'i kryej obligimet e faturuara me kohë.
- Rekomandimi B2** Ministri duhet të forcoj kontrollet e brendshme dhe nga zyrtarët përgjegjës të kërkoj zbatimin rigoroz të procedurave, duke filluar nga inicimi i shpenzimeve deri në kryerjen përfundimtare të pagesave.

3.1.3 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 300,000€. Prej tyre në vitin 2018 ishin shpenzuar 299,925€. Ato kanë të bëjnë me asistencën e komuniteteve. Ne kemi testuar 11 mostra substanciale dhe kemi kryer 10 teste të pajtueshmërisë, dhe kemi identifikuar çështjet si në vijim.

Çështja A3 – Menaxhimi dhe monitorim i dobët i subvencioneve**Gjetja**

Udhëzuesi për subvencionimin e projekteve i MKK-së nr. 2431 datë 16.11.2017, pika 13 parasheh detyrimet e përfituesit të subvencionit. Përfituesit e projekteve janë të detyruar të dorëzojnë raportin përfundimtar narrativ, financiar dhe të ofrojnë dëshmi (fatura dhe dokumente të tjera) se subvencioni është realizuar sipas planit dhe në pajtim të plotë me këtë udhëzues.

MKK me datën 06.07.2018 kishte subvencionuar në shumë 3,960€ projektin “Organizimi i turnirit tradicional të Vidovdanit në futboll të vogël”. Ky projekt parashihej të mbahet nga data 10 deri 28 qershor 2018. Ne kemi identifikuar se përfituesi i subvencionit nuk kishte ofruar asnjë raport financiar për mënyrën e shpenzimit të mjeteve;

Te subvencioni i dhënë për “Përkrahje për mbulimin e shpenzimeve për blerjen e pajisjeve për fermë të derrave” në vlerë 4,980€, përfituesi kishte ofruar dëshmi vetëm për shumën 500€ ndërsa pjesën tjetër (4,480€) nuk kishte ofruar dëshmi siç kërkohet me udhëzues. Shkaku i mos raportimit me fatura është se pajisjet janë blerë nga personat fizik.

Te subvencioni për “Blerja e pajisjeve për zgjerimin dhe rritjen e prodhimit të malinave” në vlerë 4,915€, përfituesi kishte ofruar dëshmi vetëm për shumën 2,215€, ndërsa për pjesën tjetër (2,700€) nuk kishte dëshmi adekuate (faturë) por kishte sjellë një vërtetim për blerjen e pajisjes.

Te subvencioni “Zgjerimi i bletarisë dhe prodhimi i mjaltës” në vlerë 4,250€, përfituesi kishte ofruar dëshmi vetëm për shumën 1,275€, ndërsa pjesën tjetër në shumë 2,975€ nuk kishte dëshmi.

Te subvencioni për “Mbulimin e shpenzimeve për prodhimin e produkteve qumështore” në vlerë 4,650€, përfituesi kishte ofruar dëshmi me faturë vetëm për shumën 1,050€, ndërsa për pjesën tjetër në vlerë 3,600€ kishte sjellë një dokument për shitblerje pa vlerë financiare (jo faturë).

Rastet më sipër kishin ndodhur për shkak të monitorimit të dobët të ministrisë ndaj përfituesve të subvencioneve.

Rreziku

Mungesa e raportimit financiar nga përfituesit për realizimin e projekteve rritë rrezikun që mjetet e dhëna të mos realizohen sipas kërkesës së aprovuara dhe të keqpërdoren për qëllime tjera.

Rekomandimi A3

Ministri duhet të siguroj se kërkesat e rregullores për subvencione zbatohen me konsistencë në të gjitha rastet, duke përfshirë edhe procesin e mbikëqyrjes në realizimin e projekteve dhe procesin e raportimit të shpenzimeve.

3.1.4 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 6,900,000€. Prej tyre në 2018 ishin shpenzuar 6,657,497€. Ato kanë të bëjnë me projektet për ndërtimin e shtëpive për të kthyerit, projektet për furnizim me material ndërtimor për komunitetin serb në shumicën e rasteve dhe financime të projekteve tjera që ndërlidhën me komunat si Komuna e Shtërpcës dhe Komuna e Novobërdës.

Çështja A4 - Dobësi në procesin e mbikëqyrjes të projektit i ndërtimit të shtëpive për të kthyerit**Gjetja**

Bazuar në Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik, pika 61.20 përcakton se “menaxherët e Projektit duhet të sigurojnë që operatori ekonomik i përmbushë të gjitha obligimet e performancës apo dërgesës në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës”.

Në kuadër të projektit “Ndërtimi i shtëpive për të kthyerit” ne kemi ekzaminuar fizikisht dy objekte (shtëpi) të ndërtuara nga MKK për komunitetin serb, dhe identifikuam mangësitë si në vijim:

Te ndërtimi i objektit (shtëpi 95m²) në fshatin Preoce – Graçanicë, vlera e projektit ishte 34,657€. Shtëpia ende nuk ishte përfunduar në tërësi. Ne kemi testuar pagesën 32,019€ që ndërlidhet me këtë projekt duke ekzaminuar pozicionet 4.13 (Furnizimi dhe punët e muratimit suvatimit), 6.1 (Furnizimi dhe punët e dyshemesë), 7.2 (Furnizimi, dhe punimet e zdrukthëtarisë), 8.3 (Furnizimi dhe punët e qeramikës) dhe 11.16, 11.17, 11.19, 11.20, 11.24, 11.27 që ndërlidhet me furnizimin dhe punët e ujësjellësit dhe identifikuam që punimet për këto pozicione në vlerë 2,326€, nuk ishin kryer fare. Për më shumë, ne kemi vërejtur që në terren montimi i stiroporit ishte me dimensione 3 centimetër, ndërsa ishte paguar për 5 centimetër.

Te ndërtimi i objektit (shtëpi 62m²) në Shtërpcë, vlera e projektit ishte 24,886€, shtëpia ende nuk ishte përfunduar në tërësi. Ne kemi testuar pagesën 21,626.99€ që ndërlidhet me këtë projekt duke ekzaminuar pozicionet 8.3 (Furnizimi dhe vendosja e granitit artificial jo i rrëshqitshëm të klasit I-rë, në shkallët e hyrjes dhe terracë) dhe 14.1 (Furnizimi dhe punimi i rrethojës metalike për shkallë dhe ballkon me lartësi h=0,9 m ku në llogari të përfshihen komplet punimi dhe ngjyrosja) dhe identifikuam moskryerje të punëve në vlerë 571€.

Vlen të theksohet se pagesat ishin ekzekutuar bazuar në raportet e menaxherëve regional të kontratës. Me datën 01.03.2019 ne kemi ekzaminuar punimet në terren dhe kemi vërejtur se punimet nuk ishin kryer sipas kushteve të kontratës.

Kjo kishte ndodhur për shkak se menaxherët regional të kontratës kishin nënshkruar raportet që punët janë përfunduar në muajin dhjetor të vitit 2018 përderisa ato nuk ishin finalizuar.

Rreziku

Nënshkrimi i raporteve nga menaxheret e kontratave para se punimet e kontraktuara të jenë kryer, rritë rrezikun e dëmtimit të buxhetit të ministrisë si dhe mos përfitimin e vlerës për parane e shpenzuar.

Rekomandimi A4 Ministri duhet të siguroj që mbikëqyrja e projekteve të jetë më efektive për tu siguruar që ekzekutimi i punimeve të kryhet në pajtim me kushtet e kontratës dhe pagesat janë kryer vetëm për punët apo shërbimet e kryera.

Çështja A5 Dobësi në zhvillimin e procedurave të prokurimit

Gjetja Neni 28 i Ligjit të prokurimit publik përcakton se "specifikat teknike për kontrata pune, duhet të përfshijnë si pjesë substanciale të veten një projekt ekzekutiv".

MKK kishte zhvilluar aktivitetin e prokurimit për projektin "Asfaltimi i rrugës në fshatin Koretishtë të Komunës së Novobërdës në vlerë 58,605€", pa hartuar paraprakisht një projekt ekzekutiv.

Po ashtu, në projektin "Ndërtimi i Qendrës së Mjekësisë Familjare në Komunën e Ranillugut" në vlerë 247,690€, MKK ka zhvilluar aktivitetin e prokurimit pa projekt ekzekutiv.

Shkaqet e zhvillimit të procedurave të prokurimit janë se Komunitat përkatëse për realizim të projekteve kishin ofruar vetëm projektet ideore, dhe jo projektin ekzekutiv me ç' rast zyra e prokurimit kishte zhvilluar procesin e prokurimit.

Rreziku Zhvillimi i procedurës së prokurimit pa projekt ekzekutive, rritë rrezikun që projekti të mos realizohet sipas standardeve të pranuarra të ndërtimit dhe për pasojë mos marrjen e vlerës së duhur për paratë e shpenzuar

Rekomandimi A5 Ministri duhet të shtoj kontrollet për të siguruar se zyra e prokurimit nuk do të bëjë iniciimin e procedurave të prokurimit për kontratat e punës pa projekt ekzekutiv.

3.2 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Vlera e pasurisë mbi 1,000€ e prezantuar në PFV e vitit 2018 është 9,877,065€ ndërsa vlera e pasurisë nën 1,000€ ishte 12,926€.

Çështja B3 - Mos azhurnimi regjistrir të pasurisë nën 1,000€

Gjetja Rregullorja Financiare MF- Nr. 02/2013 Për Menaxhimin e Pasurisë Jo Financiare në Organizatat Buxhetore neni 6 përcakton se çdo Organizatë Buxhetore duhet t'i regjistroj pasuritë jo kapitale në sistemin e-pasuria.

Gjatë auditimit të pasurisë nën 1,000€ kemi identifikuar që 5 pajisje në vlerë 3,005€ nuk ishin regjistruar në sistemin e-pasuria.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së komunikimit të brendshëm. Pra zyra e financave edhe pse kishte bërë pagesën, nuk kishte informuar zyrtarin e pasurisë për blerjet që janë bërë në muajin dhjetor 2018.

Rreziku Mos regjistrimi i pasurive nën 1,000€ në sistemin e-pasuria ndikon që vlera e pasurive të mos jetë e plotë dhe rritet rreziku i humbjes, dëmtimit apo keqpërdorimit të pasurive.

Rekomandimi B3 Ministri duhet të siguroj se të gjitha blerjet të regjistruhen në regjistrat adekuat të pasurive në mënyrë që regjistri i pasurive nën 1,000€ të jetë i saktë dhe i plotë.

3.3 Obligimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2018 ishte 22,888€. Obligimet e papaguar ishin për kategorinë mallra dhe shërbime si rezultat i sjelljes së faturave me vonesë në nga operatorët në ministri. Këto obligime janë bartur për t'u paguar në vitin 2019.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

4 Qeverisja e mirë

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmer veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i listave kontrolluese të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat në fund të vitit i dorëzohen Ministrisë së Financave.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentët tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ekziston një numër i dobësive të qeverisjes brenda MKK-së veçanërisht në lidhje me monitorimin e projekteve kapitale dhe kategorisë së subvencioneve, po ashtu vërehen dobësi të theksuar në menaxhimin e pasurive. Mungesa e monitorimit të zbatimit të rekomandimeve dhe i operimit të një sistemi cilësor i auditimit të brendshëm, nuk janë në nivelin e duhur. Komiteti i auditimit edhe pse është i themeluar dhe kishte mbajtur katër takime, nuk ishte efektiv për të promovuar raportet e auditimit të brendshëm.

MKK e ka strategjinë 2014-2018 e cila kishte të përlogaritur edhe koston financiare. Po ashtu, ministria kishte përgatitur pyetësorin e vetëvlerësimit me kohë si dhe kishte hartuar listën e rreziqeve me të cilët përballet.

4.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me tre anëtarë të stafit - Drejtori i NjAB dhe dy auditor. Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës i punës që reflekton rreziqet financiare dhe të tjera të entitetit të audituar dhe që ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Ndikimi i raporteve të Auditimit të Brendshëm duhet të gjykohet nga rëndësia që i jep menaxhmenti adresimit të rekomandimeve si dhe nga mbështetja e ofruar nga një Komitet efektiv i Auditimit.

NjAB për vitin 2018 kishte planifikuar dhe përfunduar shtatë (7) raporte të auditimit. Raportet kishin të bëjnë me buxhet dhe financa, kategorinë mallra dhe shërbime, subvencione, prokurim, personel, shpenzimet dhe menaxhimi i autoparkut dhe Teknologjinë Informativë. Komiteti i auditimit kishte mbajtur katër takime gjatë vitit 2018.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandim për këtë fushë.

4.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranim i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një

proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Menaxhmenti ka dizajnuar sisteme të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar, përfshirë strukturën organizative dhe linjat e llogaridhënies. Sekretari i Përgjithshëm mban takime të rregullta javore me Drejtor të Departamenteve. Për këto takime përhatiten procesverbale ku pasqyrohen aktivitetet e ndryshme operative.

5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e vitit 2017 të MKK-së ka rezultuar në 12 rekomandime kryesore. MKK kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatohen rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2018, pesë (5) rekomandime janë zbatuar, një (1) ishte adresuar pjesërisht, tri (3) nuk janë adresuar dhe tri (3) konsiderohen të mbyllur të pazbatuara. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shih Tabelën 4.

Rekomandimi

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2018

Nr.	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2017	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim	Ministri duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes. Duhet të ndërmerren veprime konkrete lidhur me projektet kapitale të cilat janë finalizuar nga MKK. Ato projekte duhet të largohen nga regjistri i pasurive të ministrisë dhe të barten te përfituesit e caktuar. Po ashtu, duhet të siguroj regjistrimin e të gjitha pasurive jo kapitale në regjistrat adekuat.	Menaxhmenti nuk kishte ndërmarr asnjë veprim konkret. Edhe në vitin 2018 është situatë pothuajse e ngjashme sa i përket kësaj çështje.	Rekomandime të pa zbatuara.
2	Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim	Ministri duhet të shtoj kontrollet në mënyrë që detyrimet kontingjente të raportohen dhe shpalosen drejtë në PFV. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të nënshkruhet përveç nëse ndaj PFV-ve janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.	MKK nuk ka detyrime kontingjente	Rekomandim i zbatuar.
3	Planifikim i dhe Realizimi i Buxhetit	Ministri duhet të siguroj se gjatë procesit të planifikimit të projekteve kapitale bëhet një vlerësim i mirëfilltë duke planifikuar dhe specifikuar saktë të gjitha projektet që do të realizohen gjatë vitit.	Menaxhmenti nuk kishte ndërmarr asnjë veprim konkret. Gjendja e ngjashme është edhe në vitin 2018.	Rekomandim i pa zbatuar.
4	Menaxhimi i Personelit	Ministri duhet të marrë masa të menjëhershme që për pozitat të cilat mbulohen me ushtrues detyre bëhet një zgjidhje e qëndrueshme me pozita të rregullta në pajtim me kërkesat ligjore.	Menaxhmenti pozitat e tilla i ka	Rekomandim i zbatuar.

			mbuluar me pozita te rregullta.	
5	Mallra dhe shërbime	Ministri duhet të siguroj se në specifikacionet teknik nuk do të vendosen prodhime specifike apo shenja dalluese të një artikulli.	Gjatë testimit tonë nuk kemi hasur kësi lloj mangësive , mirëpo situata e konstatuar në raportin e vitit të kaluar nuk të ndryshohet për shkak se kontrata është realizuar	Rekomandim i mbyllur i pa zbatuar.
6	Mallrat dhe shërbimet, si dhe shpenzimet komunale	Ministri duhet të iniciojë një rishikim të brendshëm dhe të ndërmerr masat e duhura për të siguruar që dështimet e ngjashme nuk do të ndodhin në të ardhmen.	Menaxhmenti nuk kishte ndërmarr asnjë veprim konkret. Situatë e ngjashme është edhe vitin 2018.	Rekomandim i pa zbatuar.
7	Mallrat dhe shërbimet, si dhe shpenzimet komunale	Ministri duhet të rishikojë vendimet për lejimin e shfrytëzimit 24h të automjeteve zyrtare nga stafi i ministrisë dhe ato të lejohen vetëm në raste specifike siç e parasheh udhëzimi.	Menaxhmenti kishte ndërmarr veprim konkret duke anuluar vendimet për përdorim të veturave	Rekomandim i zbatuar.

			24h.	
8	Subvencione dhe Transfere	Ministri duhet të siguroj që projekti të realizohet sipas marrëveshjes së planifikuar në mënyrë që subvencionit të arrij objektivat e caktuara si dhe të forcoj kontrollet në të gjitha nivelet gjatë procedimit të pagesave.	Njëri projekt ai që ka të bëjë me dru është barazuar ndërsa projekti tjetër nuk ka ofruar deshmimi	Rekomandim pjesërisht i zbatuar
9	Investimet Kapitale	Ministri duhet të siguroj se stafi përgjegjës ndjekin udhëzimet e kërkuara për përgatitjen e dosjes së tenderit dhe kushteve të kontratës në pajtueshmëri me kërkesat ligjore.	Zhvillimi i procedurave të prokurimit në vitin 2018 nuk kanë pasur mangësitë e vitit paraprak, përderisa situata për vitin 2017 nuk mund të ndryshohet për shkak se projekti ishte përmbyllur.	Rekomandim i mbyllur i pa zbatuar.
10	Investimet Kapitale	Ministri duhet të shtoj kontrollet me rastin e përgatitjes së paramasës dhe parallogarisë duke siguruar se sasitë indikative do të përcaktohen duke u bazuar në nevojat reale për furnizime. Më tutje, për të siguruar se kontrata është duke u implementuar ashtu siç ishte paraparë ministri duhet të siguroj monitorimin e vazhdueshëm të kësaj kontrate.	Furnizimet në vitin 2018 nuk kanë tejkaluar përqindjen e lejuar me rregulla të prokurimit.	Rekomandim i zbatuar.
11	Progresi i zbatimit të rekomandimit	Ministri duhet të siguroj që është zbatuar plani i veprimtimit, i cili i përcakton saktë afatet kohore për zbatimin e rekomandimeve të bëra nga AP, me	MKK ka përgatitur planin e	Rekomandim i mbyllur i pa zbatuar.

	meve	stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme.	veprimet duke përcaktuar se të gjitha rekomandimet do të adresohen në një datë të caktuar. Mbeten ende rekomandimet për tu zbatuar.	
12	Sistemi i Auditimit të Brendshëm	Për të arritur përfitimin maksimal nga aktiviteti i auditimit të brendshëm, Ministri duhet të sigurojë se Plani i NJAB mbështetet në fushat me rrezik dhe ndihmon aktivitetet operative në vazhdim.	Ishte bërë plani i AB dhe ka mbuluar aktivitetet e vitit 2018.	Rekomandim i zbatuar.
Nr.	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2018		
A1	PFV	Ministri duhet të ndërmerr të gjitha veprimet për të siguruar vijueshmërinë e rregullt në punë të këtyre punonjësve duke bërë monitorimin e vazhdueshëm ashtu siç parashihet me aktet ligjore. Ministri, gjithashtu, duhet të ndërmerr të gjitha veprimet e duhura për të siguruar bartjen e pronësisë së pasurisë kapitale tek komunat për projektet e përfunduara, si dhe të siguroj prezantimin e plotë të pasurive jo kapitale në PFV.		
B1	Planifikimi i Projekteve	Ministri duhet të siguroj se gjatë procesit të planifikimit të projekteve kapitale, paraprakisht bëhet një vlerësim i hollësishëm duke planifikuar dhe specifikuar saktë të gjitha komponentat e projektit me të gjitha detajet e duhura, dhe më pas të përfshihen në planin buxhetor.		
A2	Paga dhe mëditje	Ministri duhet të rritë mbikëqyrjen dhe të forcoj disiplinën e vajtje-ardhjes në punë. Lidhur me pagesën më lartë, ne rekomandojmë që menaxhmenti ta shqyrtoj edhe një herë rregullsinë e kësaj pagese, dhe nëse nuk gjenden arsye të vlefshme për pagesë, paratë e paguara t'i kthehen buxhetit të ministrisë.		
B2	Mallra dhe Shërbime	Ministri duhet të forcoj kontrollet e brendshme dhe nga zyrtarët përgjegjës të kërkoj zbatimin rigoroz të procedurave, duke filluar nga inicimi i shpenzimeve		

		deri në kryerjen përfundimtare të pagesave.
A3	Subvencione	Ministri duhet të siguroj se kërkesat e rregullores për subvencione zbatohen me konsistencë në të gjitha rastet, duke përfshirë edhe procesin e mbikëqyrjes në realizimin e projekteve dhe procesin e raportimit të shpenzimeve.
A4	Investime Kapitale	Ministri duhet të siguroj që mbikëqyrja e projekteve të jetë më efektive për tu siguruar që ekzekutimi i punimeve të kryhet në pajtim me kushtet e kontratës dhe pagesat janë kryer vetëm për punët apo shërbimet e kryera.
A5	Investime Kapitale	Ministri duhet të shtoj kontrollet për të siguruar se zyra e prokurimit nuk do të bëjë iniciimin e procedurave të prokurimit për kontratat e punës pa projekt ekzekutive.
B3	Pasuritë jo kapitale	Ministri duhet të siguroj se të gjitha blerjet të regjistrohen në regjistrat adekuat të pasurive në mënyrë që regjistri i pasurive nën 1,000€ të jetë i saktë dhe i plotë.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Letërkonfirmimi

Zyra Kombëtare e Auditimit NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
KODI I KLASIFIKIMIT DHE I KLASIFIKIMIT			
KODI I KLASIFIKIMIT DHE I KLASIFIKIMIT			
Niveli i Dru Org. Unit	Sht. Klasif. Class. Cat.	No. i Prot. Prot. No.	Mac. i Fartëve Br. Stranice No. Pages
03	47	724	1

Zyra Kombëtare e Auditimit NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE	
KODI I KLASIFIKIMIT DHE I KLASIFIKIMIT	
KODI I KLASIFIKIMIT DHE I KLASIFIKIMIT	
Niveli i Dru Org. Unit	Sht. Klasif. Class. Cat.
03	47
No. i Prot. Prot. No.	Mac. i Fartëve Br. Stranice No. Pages
537	10 05 19
PESHTA E KLASIFIKIMIT	



Republika e Kosovës
 Република Косово / Republic of Kosovo
 Qeveria / Влада / Government
 Ministria për Komunitete dhe Kthim / Министерство за заједнице и повратак / Ministry of
 Communities and Return

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2018 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet lidhur me përmbajtjen e Raportit; si dhe,
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

g. Nenad Stojćetović

Sekretar i Përgjithshëm-Ministria për Komunitete dhe Kthim

Data: 10. Maj, 2019, Prishtinë